

MIÇO SAMARA

VËZHGIME MBI ANTONIMET ME PARASHTESA NË GJUHËN SHQIPE

Antonimia në gjuhën shqipe me format që ajo paraqitet është ende e pastudjuar mirë. Gjuhëtarë të ndryshëm shqiptarë në kërkimet e tyre e kanë prekur disa herë çështjen e antonimisë. Por këto kërkime janë të përhapura andej këndeje në vepra, gramatika ose tekste të ndryshme mësimore. Mungon gjer më sot një studim i veçantë që t'i përmbledhë rezultatet e këtyre kërkimeve, duke u thelluar në problemet që dalin gjatë studimit të antonimisë në gjuhën shqipe. Autorët që prekin këtë problem si p.sh. K. Cipo në Gramatikën e vet ose komentet e tij në veprën «Histori e Skënderbeut» të N. Frashërit, hartuesit e Fjalorit shpjegues të gjuhës shqipe (1954), pedagogët Sh. Demiraj dhe J. Stefi në tekstet e tyre mësimore për shkollat e larta, në përgjithësi, nuk janë nisur nga pozita të shëndosha e të qarta teorike mbi antoniminë. Disa herë problemi trajtohej nga pozitat e stilistikës dhe jo të lingistikës. Madje ngatërohej edhe vetë termi.¹⁾ Në këto studime, përgjithësisht, antonimia gjuhësore studjohet si antonimi që lind në bazë të kundërvënies së koncepteve. Në të vërtetë marrëdhëniet antonimike në gjuhë janë marrëdhënie që lindin në bazë të kundërvënies së kuptimeve leksikore që ato kanë²⁾. Antonimia si një karakteristikë e kuptimit leksikor të fjalës i shpreh këto marrëdhënie kundërvënieje ndërmjet kuptimeve leksikore të fjalëve fonetikiqist të ndryshme që janë të së njëjtës kategori leksiko-gramatikore; këto kuptime e mohojnë njëri tjetrin, përbëjnë skaje ekstreme në të njëjtin varg të kuptimeve të kundërta ose qëndrojnë njëri përballë tjetrit në një largësi më të madhe ose më të vogël. Një lidhje midis konceptit dhe kuptimit të fjalës ekziston: kuptimi leksikor mund të përputhet me konceptin³⁾, por jo gjithmonë kuptimet e fjalëve shprehin koncepte; fjalët shërbyese nuk shprehin koncepte por megjithatë ato kanë kuptim. Antonimia është fenomen gjuhësor, pra edhe marrëdhëniet antonimike ndërmjet fjalëve duhet të studjohen brënda kuadrit gjuhësor. Në këtë mënyrë kemi të drejtë të flasim gjithnjë për kundërvënie kuptimesh leksikore⁴⁾ dhe jo konceptesh, se për ndryshe

1) Shih «Fjalori i gjuhës shqipe» (1954). «Përveç sinonimeve, kur është dhënë rasti, është shënuar edhe fjala që ka kuptim të kundërt me atë të një fjale të caktuar (antonimi a antitezë)» fq. VI.

2) Në sistemin e kuptimeve të një fjale, ka mundësi, që vetëm disa prej kuptimeve të saj të hyjnë në marrëdhënie antonimike.

3) Në rastet kur kuptimi leksikor përputhet me konceptin kemi të bëjmë dhe me kundërvënie konceptesh.

4) «Duhet thënë se opozicioni i një fjale bën pjesë në kuptimin e asaj fjale». (Ch. Bally, «Traité de stylistique française», vol. I, bot. 2, Heidelberg 1921, f. 42).

do të ishte rrezik të kalonim jashtë kuadrin të gjuhës, në shkencën e logjikës¹).

Studimi i antonimisë në gjuhën shqipe përfshin shumë çështje me rëndësi teorike e praktike për leksikologjinë e leksikografinë shqipe siç janë: çështja e përcaktimit të antonimeve dhe e klasifikimit të tyre, antonimia ndërmjet fjalëve me parashtesa dhe fjalëve të përbëra, roli i antonimisë në gjuhë, çështja e pasqyrit të antonimeve në fjalor etj.

Në këtë kumtesë autori ka për qëllim të marrë në studim vetëm antoniminë në fjalët shqipe me parashtesa. Ky lloj i antonimisë është prekur në dispencën e hartuar nga J. Stefi si tekst mësimor për shkollat e larta.² Karakteri antonimik i fjalëve me parashtesa u ka shërbyer hartuesve të Fjalorit të gjuhës shqipe (1954) dhe K. Kristoforidhit në fjalorin e tij shqip-greqisht për të saktësuar kuptimin e fjalës duke vënë në fund të shpjegimit të saj dhe fjalë — antonimin me ose pa parashtesë p.sh. *armatos*, ft. pajis me armë, ant. *çarmatos* (Fjalor i gjuhës shqipe, 1954, fq. 16), (të) *pabrumë-të*, eas, k. të *mbrumë-të*, *shpengoj-onj* dhe *çpengoj-onj*, k. *pengoj-onj*. (Fjalor shqip-greqisht prej K. Kristoforidhit, përpunuar prej prof. A. Xhuvanit, 1961, fq. 248 dhe 336).

Në punimin e A. Xhuvanit dhe E. Çabejt «Parashtesat e gjuhës shqipe»³) antonimia del si karakteristikë dalluese e funksioneve që luajnë parashtesat. Duke folur për funksionin antonimik të parashtesave autorët e këtij punimi thonë: «... ka fjalë ku primitivi... nuk ekziston më, ka humbur dhe ka mbetur vetëm forma e pajisur me parashtesë ose krahas me këtë ruhet shumë-shumë opoziti, fjala e formuar me një parashtesë që jep kuptimin e përkundërt». Në hyrjen e fjalorit të K. Kristoforidhit, përpunuar prej A. Xhuvanit jepen disa çifte fjalë-antonimesh me parashtesa, të cilat «nuk ishin vù në shkronjën përkatëse, simbas radhës alfabetike por... bashkë me antonimet e tyre»⁴) p.sh. *çmallënjehem-mallënjehem*, (i,e) *paturpshëm-i turpshëm*, *praparojë-pararojë*, dhe që përpunuesi pastaj i ka vënë në vendin e vet.

Gjatë studimit të antonimisë me parashtesa në gjuhën shqipe dalin disa probleme. Këto probleme janë: në se kundërvënia e kuptimeve leksikore që shprehin fjalë-antonimet me parashtesa në gjuhën shqipe justifikohet nga ana semantike dhe strukturore, në çfarë shkalle paraqitet kjo kundërvënie (e plotë ose jo e plotë), në se varet shkalla e kundërvënies nga lloji i parashtesës, antonimia sinonimike midis fjalëve me parashtesa; pasqyrimi i tyre në fjalor etj.

1) Ja si shprehet për këtë çështje V. N. Komisarov: Harresa e faktit që antonimet janë grupe të veçanta fjalësh dhe jo koncepte, mund të shpjegë lehtë në mospërfilljen e fakteve gjuhësore dhe në ngatërimin e kategorisë logjike me atë gjuhësore, p.sh. në artikullin e M. D. Lesnik ne gjithmonë ndeshim në pohime të këtij tipi: «jo të gjithë konceptet mund të jenë antonime. Koncepti sladjik (i ëmbël) mund të ketë në të njëjtën kohë dy antonime» etj. Nganjëherë autori arrin në një mohim faktik të ekzistencës objektive të antonimeve si fenomene gjuhësore. Kështu artikulli thotë se «kuptimi i antonimisë mund të zhduket gjatë shqyrtimit të aspekteve të ndryshme të konceptit» («Problemi i përcaktimit të antonimeve» në Voprosi Jazikoznaniya, — Moskë, 1957, Nr. 2, f. 52).

2) J. Stefi, *Leksikologjia Shqipe*, Tiranë, 1961, fq. 36.

3) Bul. U. Sht. Tiranës, Shk. Shoq. 1956 Nr. 4 fq. 66.

4) Fjalor shqip-greqisht prej K. Kristoforidhit, përpunuar prej prof. A. Xhuvanit, 1961, fq. 9.

Në antoniminë midis fjalëve me parashtesa në gjuhën shqipe karakteristika antonimike përcaktohet nga pjesëmarrja e parashtesës së element fjalëformues, e cila i ngjitet temës së fjalës, duke formuar një fjalë të re që ka kuptim të kundërt me atë të fjalës pa parashtesë. Fjala me parashtesë del si antonim me vetë fjalën pa parashtesë. Në antoniminë midis fjalëve me parashtesa marrin pjesë parashtesa me funksion, përgjithësisht, mohues ose privativ. Kuptimi i parashtesës në këto fjalë zbulohet pikërisht duke vënë përballë kuptimit të fjalës së tërë kuptimin e fjalës pa parashtesë. Kuptimi i fjalës me parashtesë i kundërvihet kuptimit të fjalës pa parashtesë, e privon atë nga kuptimi i parë, e mohon atë plotësisht ose jo plotësisht. Një antonimi i tillë vihet re midis fjalëve shqipe me këto parashtesa.

anti- psh. *antikombëtar-kombëtar, antipopullor-popullor, anti-imperialist-imperialist, antifashist-fashist.*

ç- (me format *c-a x-, s-a z-, sh-, xh-, zh-*) psh. *çbëj-bëj, çmësohem-mësohem, çlodhem-lodhem, çnjerëzor-njerëzor, shqep (çqep)-qep, çpengoj-pengoj, i çngjitur-i ngjitur, çpërvesh-përvesh, shpërkoq-përkoq, shpalos-palos, zbërthej-mbërthej, zbuloj-mbuloj, zhduket-duket.*

çpër- a *shpër-* p.sh. *çpërdreth (shpërdreth)-dreth, shpërnderoj-përkoq, shpalos-palos, shfryj-fryj, zberthej-mberthej, zbuloj-mbuloj, zhduket-duket.*

çpër-a shpër- p.sh. *çpërdreth (shpërdreth)-dreth, shpërnderoj-nderoj.*

kundër- p.sh. *kundërrevolucion-revolucion, kundërhelm-helm, kundërsulm-sulm, kundërgoditje-goditje.*

m(ë)-a mb(ë)- psh. *mbështjell-shtjell, mshel-çel.*

mos- psh. *mospërfillje-përfillje, mosbesim-besim, moskuptim-kuptim, mosmirënjohje-mirënjohje, mosardhje-ardhje, moskalimtare-kalimtare.*

pa- p.sh. *i palarë-i larë, i padhënë- i dhënë, i paarrirë (i pabërë) — i arrirë (i bërë), i panjohur-i njohur, i pagdhendur- i gdhendur, i paargasur-i argasur, i padëmshëm-i dëmshëm, i pahijshëm- i hijshëm, i paturpshëm- i turpshëm, i paaftë-i aftë, pabarasi-barasi.*

s- p.sh. *skamje-kamje.*

Marrëdhëniet antonimike vihen re edhe midis dy fjalëve që kanë parashtesa të ndryshme dhe pjesën tjetër të fjalës të njëjtë si p.sh. midis fjalëve me parashtesat:

mbi- dhe *nën-* psh. *mbivlerësoj-nënvlerësoj, mbivleftësim-nënvleftësim, mbitoka-nëntoka, i mbidheshëm-i nëndheshëm, i mbiujshëm-i nënujshëm, mbitonik-nëntonik.*

para- dhe *prapa-* ose *pas-* p.sh. *parashtesë (parashtim)-prapashtesë (prapashtim), pararojë-praparojë, padreke-pasdreke.*

k- dhe *a-* (njëra u ngjitet temave të fjalëve që tregojnë afërsi dhe tjetra temave të fjalëve që tregojnë largësi) psh. *këtu-aty (atje), këndej-andej, i këtushëm-i atjeshëm.*

Mendojmë se analiza semantike dhe strukturore e antonimeve me parashtesa është e nevojshme dhe e domosdoshme për zberthimin e drejtë të përmbajtjes kuptimore dhe përcaktimin e shkallës së kundërvënies së tyre.

Për të përcaktuar shkallën e kundërvënies midis kuptimeve të fjalë-antonimeve duhet të dallojmë: antonimet e mirëfillta dhe antonimet jo të mirëfillta. Kuptimet leksikore që shprehin fjalët me rrënjë

të ndryshme i *bardhë-i zi, ngrihem ulem, natë-ditë, poshtë-lart* i kundërvihen njeri tjetrit dhe përbëjnë skaje ekstreme në vargun e kuptimeve të kundërta. Antonimia midis kuptimeve të këtyre fjalëve është e mirëfilltë. Një antonimi gati të tillë¹⁾ të mirëfilltë vërejmë edhe midis fjalëve me parashtesa si p.sh. *shpik-pik, shpalos-palos, shkrin-ngrin, çvidhos-vidhos, çqep-qep, çkurdis-kurdis, çlodhem-lodhem, xhvesh-vesh, zbërthej-mbërthej, skamje-kamje, kundërrevolucion-revolucion, pabarasi-barasi, mospërfillje-përfillje* (shih Fjalorin e gjuhës shqipe, 1954). Marrëdhëniet antonimike midis këtyre fjalëve janë të plota, mohimi ose privimi i kuptimit të fjalës pa parashtesë bëhet i plotë, forca antonimike midis tyre është e madhe. Kështu, kuptimi që ka fjala *xhvesh* (heq petkat nga shtati), e privon krejt kuptimin e fjalës *vesh* (mbuloj shtatin me petka). Kuptimi i fjalës *kundërrevolucion* e mohon plotësisht kuptimin e fjalës *revolucion*; midis fjalëve që shprehin këto dy kuptime të kundërta nuk ka vend asnjë fjalë tjetër, kuptimi i së cilës të qëndrojë në mes të tyre si një gjymtyrë e tretë. Kuptimet leksikore të këtyre fjalëve përbëjnë skaje ekstreme në vargun e kuptimeve të kundërta, pra edhe shkalla e kundërvënies midis kuptimeve të tyre është e plotë.

Në çiftet: *mbivlerësoj-nënvlerësoj, i mbidheshëm-i nëndheshëm, paradreke-pasdreke, pararojë-praparoje, këndeje-andej*, (shih Fjalorin e gjuhës shqipe, 1954) marrëdhëniet antonimike të plota nga ana semantike janë më të justifikuara edhe nga ana strukturore; për më tepër aty mund të vendosen marrëdhënie të plota antonimike edhe midis vetë parashtesave koresponduese (*mbi-nën* dhe *para-pas*). Antonimia midis këtyre fjalëve është e mirëfilltë.

Pra, duke bërë analizën semantike të fjalë-antonimeve me parashtesa, rezultojnë si antonime të mirëfillta ato fjalë, kuptimet leksikore të të cilave hyjnë në marrëdhënie të plota antonimike dhe përbëjnë skaje ekstreme në vargun e kuptimeve të kundërta.

Ndryshe qëndron puna me marrëdhëniet opozicionale që ekzistojnë midis kuptimeve të fjalëve *moskryerje-kryerje, mosardhje-ardhje, mosregjistrim-regjistrim, i pazhvilluar-i zhvilluar, i papregatitur-i pregatitur, i pasitur-i situr, i paargasur-i argasur, i papunuar-i punuar*. Këto fjalë mund të hyjnë në marrëdhënie kundërvënieje, por kuptimet e tyre nuk janë gjithnjë skaje ekstreme të vargut të kuptimeve të kundërta. Në këto raste kuptimet leksikore të fjalëve qëndrojnë përballë njëri tjetrit në një largësi më të vogël. Në vargun e kuptimeve të kundërta të fjalëve *mosregjistrim-regjistrim* vemë re se kuptimi i fjalës *mosregjistrim* jo thjesht mohon kuptimin e fjalës *regjistrim*. Kuptimi i fjalës së parë përmban në vetvehte dhe diçka pozitive. Kjo gjë vihet re në kontekstin: «*shihen shuma të shkrojtura me lapës, të fshira e të zhgaravitura, gjë që le të dyshohet në mosregjistrimin e çdo gjëje me përpikmëni*». (Gaz. Bashkimi, dt. 18-6-47, fq. 3). Marrëdhëniet antonimike që ekzistojnë midis kuptimeve të këtyre dy fjalëve janë të njellojta me marrëdhëniet antonimike që ekzistojnë midis kuptimeve të fjalëve *mosorganizim* dhe *organizim*²⁾. Kuptimi i fjalës

1) Qështja, në se mund të konsiderohen antonimet me parashtesa të njëvlerëshme semantikisht me antonimet që kanë rrënjë të ndryshme, është një çështje me interes të madh teorik e praktik, e cila duhet të studjohet veçan.

2) E njëjtë është edhe kundërvënia midis kuptimeve të fjalëve të tjera mbiemra ose emra foljorë antonimikë, të formuar me parashtesat *pa-*, *mos-*, ose të fjalëve me parashtesën *anti-*.

mosorganizim nuk e mohon krejtësisht kuptimin e fjalës *organizim* por përmban në vetvehte edhe elemente pohuese, p.sh. «*Komunistët kritikuan dobësitë ... në mosorganizimin e mirë të punës*» (Gaz. Zeri i Popullit, dt. II-I-62, fq. 2). Në një distancë më të largët në vargun e kuptimeve të kundërta qëndrojnë kuptimet e fjalëve *çorganizim* dhe *organizim*. Kuptimi i fjalës *çorganizim* jo vetëm e mohon kuptimin e fjalës *organizim* por edhe e privon atë nga çdo mundësi tjetër kuptimi, që t'i afrohet sadopak kuptimit të fjalës së dytë (p.sh. «*kudo shifej çorganizim*» Histori e Përgj. Tiranë, 1961, fq. 255). Privimi i kuptimit këtu, përmban jo vetëm mohimin e tij, por edhe diçka më tepër, që çduk çdo mundësi për të lënë vend në mes të dy fjalëve të çiftit antonimik një fjalë tjetër që të hyjë si gjymtyrë e tretë, e mesme. Kundërvenia midis kuptimit të fjalës së formuar me parashtesën ç- dhe kuptimit të fjalës koresponduese pa parashtesë është më e plotë se sa kundërvenia midis kuptimit të fjalës së formuar me parashtesën mos- dhe kuptimit të fjalës koresponduese pa këtë parashtesë. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për marrëdhëniet antonimike ndërmjet kuptimeve të fjalëve *i paarmatosur-i armatosur* dhe *i çarmatosur*. Mund të konkludohet se rastet ku marrëdhëniet antonimike çfaqen jo të plota, të dobëta, janë më të shpeshta midis kuptimeve të fjalëve të formuara me parashtesat mohuese: *mos-e pa-*. Pjesa më e madhe e fjalëve antonimike shqipe të formuar me këto parashtesa janë antonime jo të mirëfillta.

Pra, gjithënjë duke bërë analizën semantike të fjalë-antonimeve me parashtesa, rezultojnë si antonime jo të mirëfillta ato fjalë-antonime me parashtesa, kuptimet leksikore të të cilave hyjnë në marrëdhënie jo të plota kundërvënije; forca antonimike midis tyre është e dobët dhe nuk përbëjnë gjithnjë skaje *ekstreme* në vargun e kuptimeve të kundërta.

Analiza strukturore e fjalë-antonimeve shqipe me parashtesa do të sqaronte më mirë klasifikimin semantik të tyre dhe do të ndihmonte nga ana praktike pasqyrimin e tyre në fjalor.

Në antoniminë midis fjalëve me parashtesa kemi të bëjmë me fjalë që po t'u hiqet parashtesa pjesa tjetër e fjalës mbetet e njëjtë. Antonimia lind për shkak të ngjitjes së parashtesës kësaj pjesë së njëjtë të fjalës. Duke bërë analizën strukturore të fjalë-antonimeve shqipe me parashtesa, në bazë të elementeve formale që marrin pjesë në përbërjen e fjalës, mund të bëhet një klasifikim i tyre në këtë mënyrë.

a) Në grupin e parë bëjnë pjesë ato fjalë-antonime me parashtesa, marrëdhëniet antonimike midis kuptimeve leksikore të të cilave lindin për shkak të pjesëmarrjes vetëm të një parashtese si element fjalëformues i njerit komponent të çiftit antonimik, p.sh. *mosdurim-durim* («*ushtarve të rinj s'u rrihej vendit nga mosdurimi që të përlesheshin me armikun*» F. Noli, Histori e Skënderbeut, Tiranë, 1962, fq.35), *çpërfillje-përfillje*, *shpengoj-pengoj*, *çmallëngjenem-mallëngjenem*; *çpërdreth-përdreth*; *çthur-thur*. (Fjalor shqip-greqisht prej K. Kristoforidhit, përpunuar prej A. Xhuvanit). Në qoftë se do të shënonim parashtesën me germën P, pjesën e njëjtë të fjalës, që është edhe vetë tema e komponentit të dytë, me germën T, atëhere skema e çiftit antonimik për këtë grup do të ishte e tillë: P + T-e kundërt me T.

b) Në grupin e dytë bëjnë pjesë ato fjalë-antonime me parashtesa, në të cilat marrëdhëniet e kundërvënies midis kuptimeve leksikore linden për shkak të pjesëmarrjes së dy parashtesave, njera si element fjalëformues i komponentit të parë të çiftit dhe tjetra i të dytit p.sh. *mbishartesë-nënshartesë* («një ndikim reciprok i dobët i *mbishartesave* dhe *nënshartesave* vihet re kur... si *mbishartesa merren kalëma ose sythe* «N. A. Maksimov, Jeta e bimës, Tiranë, 1956, fq. 90), *mbivlerësim-nënvlerësim*, *paradite-pasdite*, *parathënie-pasthënie*, *këndeje-andej*, i *mbiujuhem-i nënujuhem*. Skema për çiftet antonimike të fjalë-antonimeve të këtij grupi do të ishte e këtillë. P+T-e kundërt me P₁+T.

Fjalë-antonimet me parashtesa të grupit të parë i kanë më të dobëta marrëdhëniet e kundërvënies. Antonimet jo të mirëfillta i gjejmë vetëm në fjalët e këtij grupi. Kurse fjalë — antonimet me parashtesa të grupit të dytë janë gjithnjë antonime të mirëfillta, kuptimi leksikor i të cilave përbën gjithnjë skaje ekstreme në vargun e kuptimeve të kundërta.

Antonimia në fjalët shqipe me parashtesa gjen një shtrirje të gjerë në përbërjen e fjalorit të shqipes. Ajo vihet re në pjesën më të madhe të kategorive leksiko-gramatikore, por në disa kategori ajo pasqyrohet më shumë dhe në disa më pak. Më të pasura në shqipet janë fjalë-antonimet me parashtesa, kuptimi leksikor i të cilave shpreh cilësi që i kundërvihen njera tjetrës; pra fjalë-antonimet prefiksale mbiemra, meqënëse mbiemri përmban më shumë tiparin cilësor të kuptimit të fjalës p.sh. i *papërlotur-i përlotur* («*Kur vdiq Skënderbeu as një sy nuk mbeti i papërlotur*. F. S. Noli, Histori e Skënderbeut, Tiranë 1962, fq. 115), i *mbidheshëm-i nëndheshëm*, i *pazoti-i zoti*, i *pashërueshëm-i shërueshëm*, i *pashterruar-i shterruar*, i *pazjerë-i zjerë*, i *papastër-i pastër*, i *patretur-i tretur*, i *paujdisur-i ujdisur*, i *pavlefshëm-i vlefshëm*, i *zbuluar-i mbuluar*, i *xhveshur-i veshur* etj. (Fjalori i shkurtër shqip-rusisht, 1951). Fjalë-antonimet prefiksale folje nuk janë aqë të shumta¹⁾ sa fjalë-antonimet prefiksale mbiemra p.sh. *mbiçmoj-nënëçmoj*, *mbath-zbath*, *çveshket-veshket*, *çkurdis-kurdis*, *çmësohem-mësohem*, *çkopsit-kopsit*, *çkridhem-kridhem*, *çënjtem-ënjtem*; *shpërkoq-përkoq* etj. (Fjalori i gjuhës shqipe, 1954). Në fushën e emrave antonimia në fjalët shqipe me parashtesa pasqyrohet më shumë se sa tek foljet, por më pak se tek mbiemrat p.sh. *mospranim-pranim*, *paraardhës-pasardhës*, *çpyllëzim-pyllëzim*, *çlodhje-lodhje*, *kundërsulm, sulm*, *çkurorëzim-kurorëzim*, *paburrëri-burrëri*, *padije-dije*, (Fjalori i gjuhës shqipe, 1954).

Sasia e madhe e parashtesave si elemente fjalëformuese e ka pasuruar shumë përbërjen e fjalorit të shqipes në fjalë-antonime prefiksale, veçanërisht këto njëzet vjetët e fundit. Në gjuhën e shkruar, sidomos në publicistikë, fjalë-antonimet me parashtesa kanë një për-

1) Kjo për arsye se parashtesat **mos-**, **pa-**, **anti-** nuk shërbejnë pothuajse fare si elemente fjalëformuese për të formuar folje, ndërsa shërbejnë më shumë si elemente fjalëformuese për të formuar mbiemra nga pjesorja e foljeve dhe emra foljore me prapashtesat **-im**, **-je**.

dorim më të gjerë se në gjuhën e folur popullore. Në gjuhën popullore përdoren dëndur fjalë-antonimet me parashtesat *ç-a sh-, s-, a z-, c- a x-, zh-* ose *pa-* dhe *shpër*. Më pak përdoren ato me parashtesat *mos-, kundër-*. Fjalë-antonimet me parashtesën *anti-* (*anti-popullor-popullor, antifashist-fashist, antikombëtar-kombëtar*) kanë gjetur përdorim të gjerë popullore që gjatë kohës së luftës sonë nacional-gjirimtare.

Megjithëse në gjuhën shqipe, rregullisht, përdoret si fjala me parashtesë mohuese ose privative ashtu dhe fjala antonimike pa këtë parashtesë, ka raste kur nuk ekziston fare fjala pa parashtesë p.sh. parashtesa *pa-* shërben për të formuar jo vetm fjalë antonimike në lidhje me fjalët pa parashtesë, por edhe për të formuar fjalë me kuptime të tjera, në të cilat nuk vihet re asnjë marrëdhënie antonimike p.sh. të *paana-t, i paemër, pabesi, i pathemeltë* (Fjalor i gjuhës shqipe, 1954).

Nuk munt të merret si antonim fjala që mohon kuptimin e fjalës pa parashtesë me anë të pjesëzave mohuese si në shëmbujt: *i mirë-jo i mirë, i bardhë-jo i bardhë, marr-nuk marr* etj., sepse pjesëzat mohuese *jo, nuk*, në këtë rast jo vetëm që nuk shërbejnë si elemente fjalë-formuese por e kuptimi i togjeve të fjalëve me pjesëzat mohuese nuk është i barabartë me kuptimin e fjalëve me parashtesa mohuese. Në këto raste kemi të bëjmë me togje të lira fjalësh, komponentet e të cilëve rruajnë kuptime të pavarura. Pjesëza mohuese mohon kuptimin e fjalës, por vetë kuptimi i fjalës nuk ndryshon. Pavarësisht në se fjala ka përpara pjesëzën mohuese ose jo, ajo nuk ndryshon kuptimin e vet të pavarur në tërësinë e saj. Ndryshe qëndron puna me parashtesat mohuese. Duke iu ngjitur fjalës si element fjalëformues parashtesa bëhet pjesë përbërëse e kësaj fjale. Fjala me parashtesën mohuese jo vetëm mohon kuptimin e fjalës pa parashtesë, por ka e karakteristikën të reflektojë dhe pohimin e kuptimit të kundërt. Pra parashtesa e shpreh me të plotë mohimin në kuptimin e fjalës ku bën pjesë si element fjalëformues. Edhe sikur pjesëzat *jo, nuk*, që përmendëm më lart, të shërbenin si elemente fjalëformuese komponenti i dytë do të kishte një shtrirje më të gjerë në kuptim dhe një kundërvënie e tillë do të ishte jo e plotë semantiksht.

Ka mundësi që kuptimi i njërit komponent të çiftit antonimik t'i kundërvihet kuptimit të një, dy a më shumë fjalëve prefiksale sinonimike p.sh. *i lujtshëm-i palujtshëm, i patundshëm* (shih Fjalorin e gjuhës shqipe 1954, fq. 323). Gjithashtu është e mundëshme të krijohet një antonimi midis një fjale dhe dy a më shumë fjalëve sinonimike që kanë parashtesa të ndryshme por pjesën tjetër të fjalës të njëjtë p.sh. *përfillje-mospërfillje, çpërfillje*. (Dhe duke shkuar përpara *babaxhanit, vazhdoi udhën e tij, duke i kthyer kurizin me çpërfillje* B. Ibanes, Kasollja përktheu F. S. Noli, Boston, 1920, f. 43. Shih dhe Fjalorin e gjuhës shqipe, 1954). Kjo ndodh për arsye se këtu parashtesa *mos-* e *ç-*, ka të njëjtën vlerë formale (hyn si element fjalëformues sinonimik) dhe semantikore, d.m.th. fjalët e prejardhura prej tyre nga e njëjta temë janë sinonime dhe «antonimizojnë» me një fjalë të vetme që në këtë rast është tema e të dy fjalëve sinonimike pa

parashtesë. Si rrjedhim, çiftet antonimike *i lujtshëm- i palujtshëm*, *përfillje-mospërfillje*, hyjnë në raporte sinonimike me çiftet antonimike *i lujtshëm- i patundshëm*, *përfillje-çpërfillje*. Pra kemi të bëjmë me sinonimi të çifteve antonimike.

* * *

Gjithçka u tha më lart vërtetohet praninë e antonimisë në fjalët me parashtesa brënda për brënda kuadrat gjuhësor të shqipes, gjë që kundërshton mendimin e disa leksikologëve, që përpigjen të lënë jashtë vëmëndjes së gjuhëtarit marrëdhëniet antonimike në fjalët me parashtesa duke u nisur nga përkufizimi ngushtësisht i kufizuar se antonimet janë vetëm fjalë rrënjësh të ndryshme. Në qoftë se pranohet përkufizimi kufizues se antonimet janë fjalë rrënjësh të ndryshme atëhere në ç'vënd nga pikpamja leksikologjike do ta fusnim këtë kategori kaq të pasur fjalësh shqipe me parashtesa, kuptimet e të cilave kanë aftësinë të hyjnë në marrëdhënie kundërvëniesh midis tyre? Në çfarë lloj raportesh kundërvëniesh duheshin futur ato në lidhje me fjalët pa parashtesa? Nga ana semantike këtu kemi të bëjmë pikërisht me fjalë, kuptimet e të cilave i kundërvihen njeri tjetrit dhe për më tepër disa herë kjo kundërvënie justifikohet mirëfilli nga ana strukturore. Kuptimet leksikore të çifteve: *mbiçmoj-nënçmoj*, *zhdukët-dukët*, *çnjerëzor-njerëzor*, *shqep(qep)-qep*, *paburrëri-burrëri* përbëjnë gati skajet më ekstreme në vargun e kuptimeve të tyre të kundërta; si rrjedhim kemi marrëdhënie të plota antonimike. Nga ana e strukturës kemi të bëjmë me fjalë fonetike të ndryshme se janë të formuara me elemente të ndryshme fjalëformuese ndonse kanë rrënjë të njëjta.

Megjithse fjalët antonimike me parashtesa mohuese, nganjëherë, i shprehin marrëdhëniet e kundërvënies më pak të plota, më të dobëta se sa fjalët antonimike me rrënjë të ndryshme, ato janë më të parapëlqyera, sepse kundërvëniet e tyre janë shprehur me kufij më të përcaktuar, meqë ato përmbajnë në vetvehte edhe fjalën e kundërt, në se mund të shprehemi kështu. Me fjalë të tjera, karakteristika antonimike e kuptimit të fjalës shprehet me një element morfologjik, me parashtesën, gjë që e bën këtë karakteristikë të vihet re më lehtë dhe më qartë.

Kështu mund të shpjegohet krijimi i shumë fjalëve me anë parashtesash mohuese, madje edhe atëhere kur ekziston antonimi me rrënjë tjetër p.sh. *çmbush* (zbras), *i papastër*, *i pamirë* (Fjalor i gjuhës shqipe, 1954). Akoma më shpesh ky shembull ndiqet kur mungon komponenti i dytë me rrënjë tjetër p.sh. *moskrasitje-a* («Për këtë ata duhet të kenë parasysh dëmet që kanë patur pemët vitin e kaluar nga moskrasitja me kujdes ... dhe kjo t'ju vlejë si eksperiencë në punën që do të bëjnë tani për krasitjen e pemëve» Gaz. Bashkimi, dt. 10.I.1965, fq. 2), *mosmirënjohje-a*, *pamundësi-a* (Fjalor i gjuhës shqipe, 1954) etj.

Çështja e pasqyrimin me shënjën «ant» të fjalë-antonimeve me parashtesa në fjalor është një problem më vehte. Në Fjalorin e gjuhës shqipe, 1954, është pasqyruar një pjesë e vogël e këtyre fjalë-antonimeve. Analiza semantike dhe strukturore që i bëjmë fjalë-antonime-

ve me parashtesa ndihmon në përcaktimin e kritereve të pasqyrimin të tyre në fjalor. Mendojmë se pasqyrimi i atyre fjalë-antonimeve me parashtesa ku marrëdhëniet antonimike paraqiten jo të plota, pra i fjalë-antonimeve jo të mirëfillta, mund të mos bëhet, se kjo gjë nuk do të ndihmonte shumë saktësimin e kuptimit të fjalës që shpjegohet dhe mund ta rëndonte fjalorin. Por, pasqyrimi në fjalor i atyre fjalë-antonimeve me parashtesa ku marrëdhëniet antonimike paraqiten të plota, ato me skemën strukturore $P + T$ e kundërt me $P, + T$, pra i antonimeve të mirëfillta, në më të shumtën e rasteve do të jetë me vënd dhe i dobishëm për të sqaruar, për të saktësuar kuptimin e fjalës që shpjegohet; kjo gjë nuk do ta rëndonte aspak fjalorin por përkundrazi, do ta bënte më të lehtë, më të kuptueshëm e më të dobishëm.

Problemi i antonimeve me parashtesa do të zgjidhet më mirë me studimet e mëtejshme që do të bëhen mbi antoniminë në gjuhën shqipe. Në përgjithësi, shkalla e kundërvënies së antonimeve me parashtesa është më e dobët në krahasim me shkallën e kundërvënies së antonimeve rrënjësh të ndryshme. Por megjithatë, kundërvënia e fjalë-antonimeve të formuara me anë parashtesash është po aqë e justifikuar në sistemin semantik të gjuhës shqipe sa edhe kundërvënia e fjalë-antonimeve me rrënjë të ndryshme. Antonimet me parashtesë përbëjnë gati pjesën më të madhe të antonimeve në gjuhën shqipe.

R É S U M É

OBSERVATIONS SUR LES ANTONYMES DE L'ALBANAIS

Considérée en général, l'antonymie en albanais est encore insuffisamment étudiée. Il manque jusqu'à nos jours une étude spéciale sur ce problème. L'antonymie est une caractéristique de l'acception du mot exprimant des rapports contraires entre les sens lexicaux. L'étude de l'antonymie en albanais comprend plusieurs questions d'importance à la fois théorique et pratique pour la lexicologie et la lexicographie albanaise. Une de celles-ci est l'antonymie préfixale. Une partie des antonymes préfixaux est reproduite dans le Dictionnaire de l'albanais (1954), le Dictionnaire albanais-grec de K. Kristiforidhi renouvelé par le prof. A. Xhuvani (1961). Ce genre d'antonymie a servi aux auteurs de ces dictionnaires à préciser mieux le sens des mots expliqués.

Dans l'antonymie préfixale, la caractéristique antonymique est déterminée par la participation du préfixe comme un élément de formation du mot, qui vient s'ajouter au thème du mot en formant ainsi un nouveau mot de sens opposé à celui du mot sans préfixe. Une telle antonymie est observée notamment entre les mots qui s'ajoutent les préfixes suivants: ç- (avec les formes c- ou x-, s- ou z-, sh- xh- zh-) çbëj-bëj, çlodhem-lodhem, çpengoj-pengoj, shpalos-palos, zhduket-duket, etc.; çper- ou shpër-: çperdreth-dreth, shpërnderoj-nderoj; pa-: i panjohur-i njohur, i paaftë-i aftë, pabarazi-barazi; ainsi qu'entree les mots à préfixes: mos-, anti-, kundër-, m(ë)- ou mb(ë)- et s-.

Des rapports antonymiques sont observés aussi entre deux mots à préfixes différents et l'autre partie du mot identique, comme p. ex. entre les mots à préfixes mbi- et nën- (mbivlerësoj-nënvlerësoj, mbitoka-nëntoka); para- et prapa- ou pas-, k- et a-.

En faisant l'analyse des mots-antonymes albanais à préfixes, résultent comme antonymes authentiques ces mots, dont les sens lexicaux entrent en rapports antonymiques et constituent des extrêmes dans la suite des sens contraires. Tels sont p. ex.: shpalos-palos, mos-përfillje-përfillje, mshel-çel, pararojë-praparojë, etc. Autrement il en est des rapports oppositionnels existant entre les sens des mots: mos-ardhje-ardhje, i pazhvilluar-i zhvilluar, i papunuar-i punuar et de tous les mots-adjectifs ou des mots verbaux antonymiques formés à l'aide des préfixes pa- et mos-, où la force antonymique entre ces mots et ceux sans préfixe est plus faible, du fait que le sens du membre à préfixe négatif porte aussi des éléments négatifs.

Si l'on marquerait d'un P le préfixe, et d'un T la partie identique du mot qui constitue également le thème du deuxième composant, alors le schéma du couple antonymique pour le premier groupe des antonymes de l'albanais serait $P + T$ contraire à T , et pour l'autre groupe $P + T$ contraire à $P_1 + T$.

Les antonymes à préfixe sont observés dans la plus grande partie des catégories lexico-grammaticales de l'albanais, mais plus nombreux sont les antonymes-adjectifs. On ne peut pas considérer comme antonyme le syntagme niant le sens du mot sans préfixe à l'aide de particules négatives, du fait que le sens du syntagme n'est pas identique au sens des mots à préfixe négatif.

Le problème des antonymes préfixaux trouvera une meilleure solution dans les études ultérieures qui seront faites sur l'antonymie de l'albanais.